




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, dhe nenit 12 paragrafi 1, 2 shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe neni 14 par. 1, 2 shkronja d), të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 25.09.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027 në Komunën e Skenderajt)

Neni 1

Miratohet-propozim vendimi Nr. 02-112/01-0039817/25, i datës 05.09.2025 Për Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027 në Komunën e Skenderajt.

Neni 2

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore është përgatitur nga grupi punues i emëruar nga Kryetari i Komunës, me mbështetjen e UN Women Kosovë, në kuadër të zbatimit të projektit "Nxitja e Fuqizimit të Grave të Zonave Rurale", i cili po zbatohet në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), me fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Neni 3

Zbatimin e këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore është i obliguar ta bëjë: Zyra për barazi gjinore, në bashkëpunim me Drejtorin për administratë, nën mbikëqyrje të Kryetarit të komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1x1 Arkivit,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 DA-së
1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbil Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL Data: 06.10.2025 VI-020-579
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
1. Zyrtari i konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesuese,

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01-112/01-0043036/25 për planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2027 në komunës e Skenderajt
I miratuar më datë: 25.09.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.09.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 25.09.2025, ka miratuar vendimin 01-112/01-0043036/25 për planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2027 në komunës e Skenderajt.

MAPL, konstaton se akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, është i bazuar në nenin 12 paragrafit 1 dhe 2 shkronja d), të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, vendimi i datës 25.09.2025, është miratua në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës së Skenderajt me, 23 vota për, 0 kundër dhe 0 absterime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.